

## **Organizata turistike**

Organizata turistike e komunës së Medvegjës është themeluar me Vendimin e Kuvendit komunal të komunës së Medvegjës numër 06-180 / 07-01 nga 1. qershori i vitit 2007.

### **Merremi me:**

- Punimin e programit për zhvillim të turizmit dhe akteve të duhura për planifikim për vendet turistike në teritorin e komunës.
- Përmirsimin e kushteve të përgjithshme të banimit në komunën e Medvegjës, si dhe përmirsimin e ekonomis turistike, të gjitha me qëllim krijimi një mjedisi tërheqës të turizmit.
- Udhëzimin dhe koordinimin e aktiviteteve të bartësve të ofertave turistike si dhe inkurajimin për ndërtimin dhe zhvillimin e infrastrukturës turistike, sportive dhe rekreative si dhe të tjera përmbajtjeve.
- Organizimin e aktiviteteve turistiko-informative të propagandës, në teritorin e komunës, të gjitha me qëllim të prezentimit dhe promovimit të pasurive turistike.
- Valorizimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurive turistike, dmth. motiveve natyrore dhe antropogjene të Jablanicës së Epërme.

Merremi gjithashtu me organizimin e ekskurzioneve, vizitave të monumenteve kulturore dhe historike, objekteve dhe lokaliteteve, vizitave të teritoreve në përcjellje të udhrrfyesve lokal, caktimin dhe njoftimin e vizitave, organizimin e manifestimeve sportive dhe kulturore. Organizojm kongrese dhe takime shkencore, seminare, merremi me ngritjen e kulturës turistike të banorëve të kësaj rrethine, pregaditjen e një marke të njohur të kësaj zone, organizojm promovime të ndryshme, anketa, vendosjen e produkteve me motive dalluese etnike të këtij rajoni, japim informata dhe tjera shërbime që nuk jan të përmendura.

### **Kontakti:**

Adresa: Organizata turistike e komunës së Medvegjës, rr.Kej pa numër.  
16240 Medvegjë

**Telefoni:** + 381 (0)16 891-348

**Faks:** +381 (0) 16 891-106

**e-adresa:** [tom@medvedja.org.rs](mailto:tom@medvedja.org.rs)